

Janar - mars 2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe 1

ATRC ndihmon forcmin e bashkëpunimit ndërkomunal në mes komunave të reja dhe atyre amë

Faqe 2

ATRC organizoi trajnim “Buxhetimi me pjesëmarrje” në komunën e Junikut

Takime publike informative për procesin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në 35 komuna te Kosovës

Faqe 3

Konferanca regjionale e Levizjes Rajonale Mjedisore “Bells”

Zgjerimi i BE-së, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në Kosovë - roli i shoqërisë civile

Faqe 4

Trajnime të përkrahura nga Care International Kosova

ATRC anëtare e grupeve punuese

Faqe 5

ATRC ofron Konsulenca - ngritje kapacitetesh

ATRC monitoron procesin e kthimit të të zhvendosurve nga vendet e treta.

ATRC NDIHMOM FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL NË MES KOMUNAVE TË REJA DHE ATYRE AMË

Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërkomunal në mes komunave të reja, të krijuara pas procesit të decentralizimit, dhe komunave amë te tyre, ATRC organizoi 6 vizita studimore në mes të komunave: Gracanicë-Prishtinë, Kllokot-Viti dhe Ranillugë-Kamenicë.

Drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendeve komunale si dhe përfaqësues të shoqërisë civile të komunave të reja dhe atyre amë gjatë këtyre vizitave patën rastin të diskutojnë për problemet, sfidat dhe rezultatet e arritura në komuna. Pjesëmarrësit gjithashtu shkëmbyen eksperiencën për procesin e hartimit, miratimit dhe të implementimit të rregulloreve komunale.

Pjesëmarrësit u shprehën se këto ishin ndër takimet e para të këtij lloji dhe se takime të tilla duhet të

organizohen edhe në të ardhmen.

ATRC në kuadër të projektit “Praktika të suksesshme – komuna funksionale”, financuar nga fondet e USAID do të vazhdoj të punoj në ngritjen e kapaciteteve të komunave të reja dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkomunal, përmes formimit të grupeve të përbashkëta punuese, të cilët do të kontribuojnë në hartimin dhe modifikimin e rregulloreve komunale.



The Advocate, është publikim tre mujor i ATRC-së, i cili synon të informojë organizatat joqeveritare, donatorët, mediat, përfaqësuesit e institucioneve etj, për aktivitetet e zhvilluara në ATRC dhe nga partnerët e saj. Shpresojmë dhe urojmë që publikimi do të jetë në funksion të informimit dhe koordinimit më të mirë të aktiviteteve në mes ATRC-së dhe organizatave të tjera joqeveritare në Kosovë. Publikimi është bërë i mundur falë gatishmërisë dhe vullnetit të stafit të ATRC-së.

**TRAJNIM DYDITOR NË KOMUNËN E JUNIKUT
“BUXHETIMI ME PJESËMARRJE”**

ATRC gjatë muajit mars 2011, në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Junikut, ka mbajtur trajnimin dy ditor me temë “Buxhetimi me pjesëmarrje”. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin anëtarët e Kuvendit Komunal, zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e Shoqërisë Civile të Komunës së Junikut.

Trajnimi u fokusua në nevojën e përfshirjes së qytetarëve në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, si një mekanizëm që u mundëson qytetarëve që të marrin pjesë në vendimmarrje që nga faza e planifikimit të buxhetit komunal deri në implementimin e tij.

ATRC gjatë këtij viti do të vazhdojë me organizimin e trajnimeve në 10 Komuna të Kosovës: Prizren, Pejë, Gjakovë, Klinë, Deçan, Istog, Suharekë, Rahovec, Malishevë dhe Dragash.

Këto aktivitete janë vazhdimësi e projektit “Zgjidhja e Konfliktit Social” të financuar nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.

ATRC gjatë vitit 2009 dhe 2010 me përkrahje të 11 komunave të Kosovës dhe në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të Bashkësive Lokale, përfaqësues të fshatrave dhe qytetarë ka identifikuar kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve.



**TAKIME PUBLIKE INFORMATIVE PËR PROCESIN E REGJISTRIMIT TË
POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË KOSOVË NE 35
KOMUNA TE KOSOVES**

Me qëllim të informimit të qytetarëve rreth procesit të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë ATRC në partneritet dhe me përkrahje nga UNOPS dhe Enti i Statistikave të Kosovës ka organizuar 35 takime publike informative me qytetarë në 35 komuna të Kosovës me pjesëmarrje të 1,310 qytetarëve.

Në këto takime të pranishëm ishin edhe anëtarët e Komisioneve Komunale të regjistrimit të cilët i informuan qytetarët më në detaje rreth procesit të regjistrimit. Theks të veçantë në këto takime iu dha

rëndësisë së pjesëmarrjes së qytetarëve në këtë proces në mënyrë që procesi i regjistrimit të jetë i suksesshëm dhe njëkohësisht për të përmbushur standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara.

Me qëllim të informimit të publikut të gjerë rreth këtij procesi ATRC veç takimeve me qytetarë organizoi edhe 5 debate televizive në 5 qytetet më të mëdha të Kosovës.



KONFERANCA REGJIONALE E LËVIZJES RAJONALE MJEDISORE "BELLS"

Nga data 24—26 shkurt 2011, në Budva të Malit të Zi, është organizuar konferenca regjionale e rrjetit BELLS me temën: Implementimi i legjislacionit lokal mjedisor si dhe harmonizimi i tij me standardet e BE-së.

Përveç koordinatoreve regional të BELLS nga gjashtë shtetet anëtare të kësaj Lëvizje, në takim morën pjesë edhe përfaqësues nga dy komuna të gjashtë shteteve anëtarë të BELLS, si: Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Nga Kosova në këtë takim morën pjesë nënkryetari i komunës së Prishtinës Z. Abdullah Hoti, kryetari i komunës së Obiliqit z. Mehmet Krasniqi, anëtari i Bordit regional të BELLS z. Isa Elezaj si dhe drejtori i ATRC dhe njëkohësisht koordinatori i Bells për Kosovë z. Kushtrim Kaloshi.

Përmes prezantimeve të përgatitura, pjesëmarrësit nga komunat e shteteve të regjionit prezantuan shembuj dhe praktika të suksesshme në implementimin e legjislacionit lokal mjedisor, duke synuar që këto praktika dhe shembuj suksesi të merren dhe dyfishohen edhe në komunat tjera të shteteve tjera.



ZGJERIMI I BE-SË, TRANSFORMIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT DHE ENERGJISË NË KOSOVË ROLI I SHOQËRISË CIVILE

ATRC si anëtare e Forumit Mjedisor me seli në Bruksel (FM) si dhe në cilësinë e partnerit implementues për Kosovë të Lëvizjes rajonale mjedisore Bells, më datë 24 shkurt 2011 ka organizuar takimin përgatitor për takimin e tretë vjetor të Forumit Mjedisor, në temën: **Zgjerimi i BE-se, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në Kosovë - roli i shoqërisë civile.**

Temat kryesore të trajtuar në takimin ishin:

1. Korniza Legjislative dhe Institucionale për Energjinë Efiçiente dhe Burimet e Energjisë së Ri përtëritshme.
2. Transpozicioni i Legjislacionit

Kombëtar me direktivat e BE-së.

3. Roli i Energjisë Efiçiente dhe Burimeve të Energjisë së Ripërtrishme për Mbrojtjen e Mjedisit

4. Aplikimi i teknologjive të pastërta në prodhimin e energjisë nga linjiti – rasti "Kosova e re"

5. Mjedisit dhe Transporti

6. Aplikimi i Energjisë Efiçiente dhe Burimeve të Energjisë së Ripërtrishme në Kosovë - Roli i organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile në Kosovë.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Integritimit dhe Drejtësisë, Ministria e Energjisë, zyra e Ombudspersonit, agjensione

qeveritare, profesor të fakultetit, ekspertë të fushës, OJQ, media etj.



TRAJNIME TË PËRKRAHURA NGA CARE INTERNATIONAL KOSOVA

ATRC me përkrahje nga Care International Kosova gjatë muajve janar-shkurt ka organizuar dy trajnime me temë "Rrjetet" dhe "Puna ekipore". Pjesëmarrës në këto trajnime ishin përfaqësues të Organizatave joqeveritare rinore nga komuna e Gjilanit, Mitrovicës dhe Pejës, përfitues të Care International Kosova.

Qëllimi i organizimit të këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të organizatave të lartëpërmendura në dhe rreth çështjeve që kanë të bëjnë me rrjetet, karakteristikat, qëllimin e themelimit dhe qëndrueshmërinë e tyre si dhe rritjen e efektivitetit të punës në organizata gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit, përmes punës ekipore.

RAPORTI DHE ANALIZA

PËRCEPTIMI I BARAZISË GJINORE NË 8 KOMUNA TË KOSOVËS

ATRC me përkrahje nga Inter-Cooperation zhvillon një sërë aktiviteteve në 8 komuna të Kosovës, të përqendruara në vlerësimin e gjendjes në komunitetet e Kosovës në implementimin e ligjit për barazi gjinore.

Përmes intervistave me zyrtarët për barazi gjinore të Komunave: Kamenicë, Novo Bërdë, Klllokot, Hani i Elezit, Kaçanik, Ranillugë, Viti dhe Shtërpce, ATRC ka zhvilluar një analizë rreth implementimit të ligjit për barazi gjinore në komunitetet e lartpërmendura, rezultatet e së cilës janë pjesë e hulumtimit "Perceptimi i barazisë gjinore në 8 komuna të Kosovës" të realizuar nga Inter-cooperation dhe të publikuar në raportin e përgatitur nga ATRC gjatë muajit shkurt.

Në konferencën e organizuar nga Inter-cooperation, me zyrtarët për barazi gjinore, drejtorët dhe zyrtarët komunal është diskutuar dhe analizuar më në detaje gjendja e përgjithshme në komunitetet e lartpërmendura në fushën e respektimit të barazisë gjinore.

ATRC ANËTARE E GRUPEVE PUNUESE

Gjatë muajit janar 2011, me kërkesë të Agjencionit të Pyjeve të Kosovës, respektivisht të Drejtorisë për: MKE, Gjueti dhe Eko-Turizëm të APK-se, është organizuar takimi i parë në mes ATRC dhe APK në lidhje me mundësitë e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve në mes dy palëve. Me kërkesë të Agjencionit, ATRC ka propozuar dhe rekomanduar dy anëtarë të Rrjetit BELLS për Kosovë: Prof. Ruzhdi Pllana dhe Hysen Nikçi, për anëtarë të grupit përkrahës në kuadër të projektit të APK-së për ruajtjen dhe kultivimin e parqeve natyrore.

Me propozim dhe vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së, drejtori i ATRC; Kushtrim Kaloshi është emëruar anëtar/e i/e grupit punues qeveritar për shqyrtimin e Projektligjit për Nisma Legjislative, bartëse e të cilit ka qenë Zyra e Kryeministrit.

ATRC OFRON KONSULENCA - NGRITJE KAPACITETESH

ATRC si pjesë e “Akademisë së Trajnimeve” të programit KCSSP, i cili synon ngritjen e kapaciteteve të organizatave partnere të programit KCSSP, gjatë periudhës janar—mars 2011 ka ofruar konsulencë për organizatat joqeveritare partnere të ISC/ATRC/CCSD dhe organizata tjera sipas kërkesës. Gjatë kësaj periudhe stafi i ATRC-së ka ofruar konsulencë në tema dhe fusha të ndryshme për 3 organizata joqeveritare; si: Lëvizja Fol, Democracy in Transition—DIT, Kosovo Advocacy Development Centre - KADC të cilat janë përqendruar kryesisht në ngritjen e kapaciteteve programore dhe financiare të stafit të organizatave të lartpërmendura, ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar, duke u përqendruar në përdorimin e formularëve dhe procedurave të parapara me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe në përputhje me kërkesat unike të donatorëve, si dhe në çështje tjera.

ATRC MONITORON PROCESIN E KTHIMIT TË ZHVENDOSURVE NGA VENDET E TRETA

ATRC në partneritet me UNHCR edhe gjatë këtij viti vazhdon me monitorimin e procesit të kthyerve nga vendet e treta. ATRC aktualisht ka të angazhuar 4 monitorues në Aeroportin e Prishtinës, të cilët në koordinim të ngushtë me përfaqësinë e UNHCR-it në Kosovë, me Policinë e Kosovës dhe Aeroportin e Prishtinës, intervistojnë dhe grumbullojnë të dhënat e nevojshme për të gjitha rastet e kthimit të Kosovarëve nga vendet e treta, qoftë kthim vullnetar ose i detyruar. Të dhënat e grumbulluara ATRC në vazhdimësi i përcjell në zyrën qendrore të UNHCR-it.

www.advocacy-center.org

MISIONI I ATRC-së

ATRC është organizatë kosovare, jo-fitimprurëse e cila synon rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në përgjithësi dhe shoqërisë civile në veçanti në proceset vendimmarrëse përmes ofrimit të shërbimeve dhe bashkëpunimit aktiv me palët me interes në vend dhe jashtë tij si një nga kushtet themelore për një shoqëri të zhvilluar dhe demokratike.

PROGRAMET KRYESORE TË ATRC

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetet e organizatave joqeveritare dhe institucioneve në Kosovë në fushën e zhvillimit të përgjithshëm organizativ, menaxhimit të projekteve, zhvillim të fushatave të suksesshme të avokimit etj.
2. Programi i administrimit të granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale përmes granteve të vogla kryesisht në fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokojë në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, përmes të cilit ATRC synon të ofrojë informacione në mënyrë elektronike në ueb faqe, në lidhje me diskutimet publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtimet e koalicioneve, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu në kuadër të kësaj komponente ofron librari me 1756 tituj të ndryshëm, si: botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin, analiza, studime, hulumtime dhe dokumente tjera me rëndësi mbi fushë veprimtarinë e organizatave joqeveritare në përgjithësi, të krijuara nga organizata joqeveritare brenda dhe jashtë Kosovës.

ADVOCACY TRAINING & RESOURCE CENTER - ATRC

RR. GAZMEND ZAJMI NR.20 PRISHTINË,

PHONE/FAX: +381(0)38 244810

E-MAIL: info@advocacy-center.org

web page: www.advocacy-center.org